

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
 SHËRBIMI SPITALOR DHE KLINIK UNIVERSITAR I KOSOVËS -  
 UNIVERSITETSKË BOLLËÇKË I KLINIÇKË SLUŽBË KOSOVA -  
 THE HOSPITAL AND UNIVERSITY CLINICAL SERVICE OF KOSOVO

ARKIVI QËNDROR - CENTRALNI ARHIV - CENTRAL ARCHIVE

Nr. i njesia org \_\_\_\_\_ Nr. Prot. \_\_\_\_\_  
 org.jed \_\_\_\_\_ Prot. no. **1135**  
 org.unite \_\_\_\_\_  
 Nr. i llog. \_\_\_\_\_ Data \_\_\_\_\_  
 Br. str. **-33-** Datum **27.03.23**  
 No. regj. \_\_\_\_\_ Data \_\_\_\_\_

**PRISHTINE - PRISTINA - PRISTINA**



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria -Vlada-Government**



**Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës**  
**Univerziteteska Bolnička i Klinička Služba Kosova-Hospital and**  
**University Clinical Service of Kosovo**  
**Qendra Klinike Universitare e Kosovës- Universitetski Klinicki Centar Kosova**  
**University Clinical Center of Kosovo**  
**Zyra e Drejtorit të Përgjithshëm**

REFERENCË:		
PËR/ZA/TO:	<b>Bordin e ShSKUK-së</b>	
CC		
PËRMES/PREKO/THROUGH:		
NGA/OD/FROM:	<b>Dr. Nargize Arënliu-Hoxhaj, U.D-Drejtor i Përgjithshëm i ShSKUK-së</b>	
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	<b>Kërkesë me prioritet</b>	
Nr. i zyrës: 038512600	Lokacioni: 3232	Data: 27.03.2023
Br. kancelarije:	Kucni:	Datum:
Room No.:	Extension:	Date:
PËR AKTIVITET/ZA AKTIVNOST/FOR ACTION		X
PËR INFORMIMIN TUAJ/ZA VASU INFORMACIJU/FOR YOUR INFORMATION		X

**Të nderuar,**

Fillimisht ju deshiroj punë të mbarë!

Kërkoj nga Bordi miratimin e planit të punës së SHSKUK-së për vitin 2023 dhe aktivitetet sipas planit. Ky dokument është me rëndësi për SHSKUK-në, për punën dhe synimet të cilat i kemi gjatë vitit 2023.

**Me respekt,**

**SHSKUK**  
SHËRBIMI SPITALOR KLINIK  
DHE UNIVERSITAR I KOSOVËS



**HUCSK**  
HOSPITAL AND UNIVERSITY  
CLINICAL SERVICE OF KOSOVO

**PLANI I PUNËS I SHSKUK-së**

**PËR VITIN 2023**

**PËRGATITUR NGA:**

**DR. NARQIZE ARENLIU-HOXHAJ – ZËVENDËS DREJTORESHË E  
PËRGJITHSHME E SHSKUK-së**

**PËR: BORDIN DREJTUES TË SHSKUK-SË**


Mars, 2023

## Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës (SHSKUK)

Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK) është institucion i formuar sipas Ligjit për Shëndetësi nga Qeveria e Republikës së Kosovës, përderisa Statuti i Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës është miratuar në mbledhjen e 148 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me vendim nr. 05/148, datë 11.09.2013. Formimi i SHSKUK është i saktësuar në nenin 62 të Ligjit për Shëndetësi. Në paragrafin e parë të këtij neni, theksohet se Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës themelohet si institucion autonom dhe i pavarur publik shëndetësor, me rëndësi të veçantë publike, me seli në Prishtinë. SHSKUK përbëhet nga institucionet e nivelit dytësor dhe tretësor të kujdesit shëndetësor në sektorin publik të shëndetësisë.

Institucionet shëndetësore të nivelit dytësor dhe tretësor të kujdesit shëndetësor, të cilat përbëjnë SHSKUK-në, janë si vijon:

- 1.1. Qendra Klinike Universitare e Kosovës (QKUK);
- 1.2. Qendra Klinike Universitare Stomatologjike e Kosovës;
- 1.3. Qendra Kombëtare e Mjekësisë së Punës në Gjakovë;
- 1.4. Qendra Kombëtare e Mjekësisë Sportive
- 1.5. Qendra Kombëtare e Telemjekësisë;
- 1.6. Spitali i Përgjithshëm në Mitrovicë;
- 1.7. Spitali i Përgjithshëm në Gjilan;
- 1.8. Spitali i Përgjithshëm në Pejë;
- 1.9. Spitali i Përgjithshëm në Gjakovë;
- 1.10. Spitali i Përgjithshëm në Prizren;
- 1.11. Spitali i Përgjithshëm në Ferizaj;
- 1.12. Spitali i Përgjithshëm në Vushtri;



1.13. Qendrat e Shëndetit Mendor me Shtëpitë për Integrim në Bashkësi;( Prishtinë, Mitrovicë, Gjilan, Prizren, Pejë, Gjakovë dhe Gjilan;

1.14. Qendra për Integrimin dhe Rehabilitimin e të Sëmurëve Kronik Psikiatrik në Shtime.

### **PLANI I PUNËS NË SHSKUK 2023**

Plani i punës në SHSKUK për vitin 2023 ka gjashtë (11) objektiva me () aktivitete.

Plani bazohet në prioritetet që kanë të bëjnë me ofrimin e shërbimeve cilësore shëndetësore në përputhje me mundësitë buxhetore të ShSKUK-së të pasqyruar në buxhetin e miratuar për vitin 2023.

#### **Ky plan parasheh këto Objektiva:**

- I. Furnizimi i qëndrueshëm dhe i rregullt me barna dhe material shpenzues mjekësorë;
- II. Reduktimi i listës së pritjes së pacientëve;
- III. Kontrolli dhe parandalimi i infeksioneve spitalore;
- IV. Avancimi i shërbimeve të reja të themeluara në vitet e kaluara dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë së shërbimeve shëndetësore;
- V. Menaxhimi efikas, rritja e transparencës dhe llogaridhënies për administratë efikase;
- VI. Furnizimi me pajisje mjekësore, servisimi dhe mirëmbajtja e tyre funksionale;
- VII. Përmirësimi dhe zgjerimi i infrastrukturës spitalore;
- VIII. Digjitalizimi i sistemeve në kuadër disa shërbimeve në QKUK në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë;
- IX. Përgatitja e planit të detajuar për reagim në emergjenca;
- X. Kontrollimi mjekësorë sistematik i stafit të SHSKUK-së;
- XI. Reformat administrative

**Objektivi I. Furnizimi i qëndrueshëm dhe i rregullt me barna dhe material shpenzues mjekësorë;**

Gjatë viteve të kaluara është stabilizuar në mënyrë të ndjeshme furnizimi me barna dhe material shpenzues mjekësorë. Gjatë viti 2023 do të vazhdohet të forcohen mekanizmat monitorues të shpenzimit të barnave, funksionalizimin e SMSF-së dhe bashkëpunimi me donatorët.

**Aktivitetet kryesore janë:**

- Planifikimi i drejtë dhe efikas për furnizim me barna dhe material shpenzues;
- Fuqizimi i mekanizmave kontrollues për monitorimin e zbatimit të planit për furnizim me barna dhe material shpenzues mjekësorë;
- Fuqizimi i mekanizmave kontrollues për shfrytëzimin racional të barnave dhe materialit shpenzues medicinalë;
- Fuqizimi dhe funksionalizimi i SMSF deri tek “end user” se paku i 80% të Klinikave të QKUK dhe ne 60% të Spitaleve të Përgjithshme;
- Shpërndarja me kohë e produkteve medicinale sipas kërkesave të njësive respektive dhe kontrolli i tyre;
- Bashkëpunimi i ngushtë me donatorët për furnizim me barna të caktuara dhe material mjekësorë.

## **Objektivi II. Reduktimi i listës së pritjes së pacientëve;**

Gjatë vitit 2022 është arritur që në disa fusha të caktuara të reduktohen listat e pritjes, madje edhe zvogëlimi i referimeve të pacientëve për trajtim jashtë institucioneve shëndetësore publike, siç është rasti me Klinikën e Oftalmologjisë dhe Elektrofiziologjisë së zemrës. Megjithatë për sëmundje të caktuara, kryesisht të natyrës kirurgjike prej vitesh janë krijuar lista të gjata të pritjes së pacientëve. Me ç'rast pacientët presin nga disa muaj e në raste të caktuara edhe me vite për kryerjen e shërbimeve mjekësore, siç është rasti p.sh me protezat e gjurit dhe kërdhokullës në Klinikën e Ortopedisë si dhe venat varikoze në Klinikën e Kirurgjisë Vaskulare. Në këto klinika, lista e pritjes daton prej vitesh. Padyshim se pandemia COVID-19 ka renduar këtë gjendje, andaj kjo e bën imperative adresimin urgjent të listave të pritjes për vitin 2023. Synimet janë që listat e pritjes të reduktohen deri në 50% përfshirë zvogëlimin (numrin) e pacientëve në pritje si dhe kohën e pritjes.

**Kjo do të arrihet përmes këtyre aktiviteteve:**

1. Revidimi/rishikimi i listave të pritjes;
2. Hartimi i planit të veprimit për reduktimin e listave të pritjes;
3. Prioritizimi i sëmundjeve – patologjive për reduktimin e listave të pritjes;
4. Sigurimi i resurseve të nevojshme (burimet në njerëz dhe buxheti) për zbatimin e planit të veprimit, si dhe zbatimi i planit për reduktimin e listave të pritjes;
5. Funkcionalizimi i Rezonancës Magnetike në Spitalin e Pejës dhe Spitalin Pediatric do të ndikojë dukshëm në reduktimin e listave të pritjes në Klinikën e Radiologjisë për Rezonancë Magnetike.
6. Vazhimi i operimit të venave varikoze me radiofrekvence do të ndikojë në reduktimin e listave të pritjes për venat varikoze, sepse bëhet me anestezi lokal, pa patur nevojë për angazhimin e anesteziologut.

## **Objektivi III. Kontrolli dhe parandalimi i Infeksioneve spitalore**

Infeksionet brenda-spitalore janë sfidë dhe për vendet me sisteme më të avancuara shëndetësore. Për sistemin tonë shëndetësorë kjo përbenë një problem serioz i cili duhet adresuar në mënyrë imediate. Mungesa e filtrave në sallat operative, mungesa e uniformave dhe mbathjeve adekuate për personelin e sallave kirurgjike, mungesa e Procedurave Standarde Operative(SOP) veçmas për njësitë e kujdesit intensiv dhe blloqet operative, furnizimet e pamjaftueshme me mjete higjienike dhe dezinfektuese, janë disa nga mungesat që parashihet të evitohen gjatë këtij viti.

**Aktivitetet kryesore janë:**

1. Themelimi i Këshillit për Infeksione Spitalore,
2. Vendosja e zonave të filtrit në të gjitha blloqet operative të klinikave të QKUK-së dhe se paku në 50% të sallave kirurgjike në Spitalet e Përgjithshme,
3. Zhvillimi i PSO për sallat kirurgjike dhe njësitë e kujdesit intensiv,
4. Sigurimi i uniformave dhe mbathjeve të mjaftueshme për personelin e sallave kirurgjike dhe dezinfektimi i rregullt i sallave kirurgjike;
5. Furnizimi me carshafa, mbulesa dhe mbështjellës të jastëkut për shtretërit e pacientëve; si dhe sigurimi i uniformes dhe mbathjes së mjaftueshme për personelin shëndetësor dhe mbështetës;
6. Krijimi i njësisë për pastrim dhe dezinfektim të shtretërve në QKUK,
7. Gjurmimi ( Screening) për bakterie shumë rezistente në njësitë më të ndjeshme (vulnerable),
8. Zvogëlimi i prevalencës së infeskioneve në HCV Qendrat e Dializës në SHSKUK

**IV. Avancimi i shërbimeve të reja të themeluara në vitet e kaluara dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë së shërbimeve shëndetësore;**

Gjatë vitit 2021 dhe 2022 është arritur që të themelohen disa shërbime shëndetësore për herë të parë në nivel të QKUK-së, siç janë: themelimi i Shërbimit të Mikrobiologjisë Klinike,

funksionalizimi i brachiterapise ne Kliniken e Onkologjisë, fillimi i shërbimeve për studimin elektro-fiziologjisë te zemrës ne Kliniken e Kardiologjisë, fillimi i operimeve të venave varikoze me Radiofrekvenca, avancimin e metodave diagnostike për sëmundjen e kancerit të gjirit në Institutin e Patologjisë, trajtimi i Infarktit Akut të Trurit përmes trombolizës, furnizimi me OCT dhe Ultrazë i reparteve oftalmologjike në të gjitha Spitalet Rajonale, përgatitja – renovimi i hapësirave për shërbimin e Fertilizimit të Asistuar IVF(fekondimit artificial) dhe laboratorit citogjenetik. Gjatë vitit 2023 planifikojmë të avancojmë këto shërbime, si dhe të themelojme/funksionalizojmë shërbime të reja:

**Aktivitetet kryesore janë:**

1. Themelimi i Shërbimit te Transportit Neonatal ne Kliniken e Neonatologjisë në QKUK,
2. Themelimi i njësisë së Fertilizimit të Asistuar Mjekësorë në Klinikën Obstetrike Gjinekologjike;
3. Avancimi dhe zgjerimi i gamës së shërbimeve mikrobiologjike në Shërbimin Mikrobiologjik te QKUK përmes:
  - a. Shtimi i stafit mjekësorë, se paku 3 teknik laborant te mikrobiologjisë;
  - b. Rritjes së sasisë së reagensëve dhe materialit shpenzues të nevojshëm mjekësorë;
  - c. Zhvillimit të sistemit të informativ te mikrobiologjisë klinike;
4. Themelimi/funksionalizimi i Qendrës për trajtimin e Infarktit Akut të Trurit ( Embolizim, Coiling, Trombectomi);
5. Themelimi i Njësisë Fetale në Klinikën Obstetrike Gjinekologjike;
6. Themelimi i njësisë për përcjelljen e pacientëve para dhe pas transplantimit të veshkës në kuadër të Klinikës së Nefrologjisë;
7. Funksionalizimi i endoskopisë pediatrike (bronhoskopia, gastroskopia dhe kolonoskopia);
8. Funksionalizimi i kirurgjisë laparoskopike dhe nefrolitotomisë perkutane në Klinikën e Urologjisë;
9. Themelimi/funksionalizimi i laboratorëve të Histopatologjisë në Spitalet e Përgjithshme;



10. Zbatimi i Planit të veprimit për furnizim të qytetarëve me proteza, ortoza dhe shërbime tjera të cilat ofrohen në SHKOP/SHSKUK ,
11. Rritja e kapaciteteve dhe cilësisë së shërbimeve oftalmologjike, si ne pjesën diagnostike ashtu edhe në atë operative në Klinikën e Oftalmologjisë
12. Sigurimi i vazhdimësisë së punës në Njësinë e Elektrofiziologjisë së Zembrës ne Kl. e Kardiologjisë deri në pavarësimin e plotë të stafit vendorë.
13. Trajtimi stomatologjik i pacientëve me Entonox ( Oksidul - Azot ), perkatesisht me proceduren e sedacionit inhalator në QKSUK,
14. Aplikimi i terapisë fikse ortodontike në QKSUK,
15. Përgatitja e sallës kirurgjike për fillimin e aplikimit të implanteve dentare në QKSUK,
16. Fillimi i realizimi të projektit për sallën kirurgjike Endovaskulare në Kirurgji Vaskulare- në bashkëpunim me MSh.
17. Fillimi i realizimi i projektit për sallën e Neurokirurgjisë-në bashkëpunim me MSh.
18. Fillimi i shërbimeve specialistike në Spitalin e Podujevës,

#### **Objektivi V. Menaxhimi efikas, rritja e transparencës dhe llogaridhënies, administratë efikase**

Llogaridhënia dhe rritja e transparencës janë dy parimet themelore me të cilat duhet të udhëhiqet një organizatë. Menaxheret e secilës Njësi Përbërëse të SHKSUK-së dhe secilit nivel hierarkik do te mbahen përgjegjës dhe llogaridhënës për punën e tyre, duke promovuar vlerat më të larta në udhëheqjen e institucioneve shëndetësore. Paralelisht me këtë, ndërtimi i një administrate efikase përmes hartimit të akteve të brendshme administrative, hartimit të planit për zhvillimin e resurseve në njerëz dhe trajnimeve profesionale, do të jenë shtyllat kryesore për realizimin e këtij aktiviteti.

#### **Aktivitetet kryesore janë:**

1. Hartimi dhe miratimi i Rregullores për sistematizimin dhe përshkrimin e vendeve te punës në QKUK.
2. Hartimi dhe miratimi i rregulloreve për organizimin e punës në të gjitha klinikat e QKUK;

3. Hartimi dhe implementimi i një plani të trajnimit me tema te nevojshme profesionale për stafin e administratës së SHSKUK-se,
4. Hartimi i planit për zhvillimin e burimeve ne njerëz-planifikimi i dinamikës së zhvillimit të burimeve në njerëz,
5. Azhurimi i rregullt i web faqes së SHSKUK/QKUK, me prioritetet si më poshtë:
  - a. Publikimi i shërbimeve mjekësore që ofrohen në secilën Njësi Përbërëse të SHSKUK-së , duke përfshirë çmimorën e shërbimeve dhe numrat e kontaktit të telefonit për secilën njësi;
  - b. Publikimi i orarit të punës së ambulancave specialiste të të gjitha Njësive Përbërëse të SHSKUK-së, përfshirë emrat e mjekëve dhe një numër kontakti për caktimin e terminëve;
6. Fuqizimi i komunikimit të drejtpërdrejtë dhe sistematik i SHSKUK-së me qytetarët dhe Shoqatën për të Drejtat e Pacientëve.
7. Vlerësimi i motivimit të stafit shëndetësorë dhe vlerësimi (matja) e kënaqshmërisë së pacientëve me shërbimet shëndetësore.
8. Ngritja e cilësisë së raporteve periodike dhe vjetore nga të gjitha njësitë përbërëse të SHSKUK,

**Objektivi VI. Furnizimi me pajisje mjekësore, servisimi dhe mirëmbajtja e tyre funksionale;**

Gjatë viteve të fundit Njësitë Përbërëse të SHSKUK-së janë pajisur me një numër të konsiderueshëm të pajisjeve mjekësore. Kështu, tashmë të gjitha Spitalet e Përgjithshme kanë aparatet e CT-ve, rezonanca magnetike, renga digjitalë, mamografë etj. Gjatë kohës së Pandemisë COVID 19, klinikat e QKUK-së dhe Spitalet e Përgjithshme kanë siguruar edhe pajisje mjekësore të nevojshme për trajtimin e pacientëve me COVID 19, sidomos: ECHO aparatura, ventilator(respiratorë), high pressure nasal aparatura, analizatorë biokimik dhe hematologjik, analizator të gazrave, monitorë, shtretër, etj.

Sidoqoftë, nevoja për pajisje mjekësore, sigurimi i pajisjeve mjekësore të avancuara vazhdon të mbetet evidente. Krahas kësaj servisimi dhe mirëmbajtja e rregullt e tyre është sfidë që kërkon përkushtim dhe angazhim të vazhdueshëm të personelit shëndetësorë dhe atij mbështetës profesional.

Në kuadër të kësaj objektive, bazuar në mundësitë buxhetore të SHSKUK-së, me qëllim të zvogëlimit të referimeve për trajtim jashtë institucioneve publike shëndetësore dhe zvogëlimin e listave të pritjes, janë prioritetizuar këto aktivitete:

1. Sigurimi e një akceleratori të ri për radioterapi për nevojat e Klinikës së Onkologjisë,
2. Sigurimi e Autoambulancës për transportin neonatal,
3. Sigurimi i aparatit për Plazmaferezë - të përbashkët për nevojat e Klinikave të QKUK;
4. Sigurimi i pajisjeve mjekësore të nevojshëm për laobartoret e histopatologjise për Spitalet e Përgjithshme.
5. Sigurimi i pajisjeve mjekësore bazuar në prioritetet e njësive të ShSKUK,
6. Servisimi i rregullt dhe mirëmbajtja e pajisjeve mjekësore – hartimi i planit operativ për servisim dhe mirëmbajtje.
7. Pajisjet për FAM, oftalmologji si dhe disa pajisje të tjera bashkëpunim me MSh.

## **VII. Përmirësimi dhe zgjerimi i infrastrukturës spitalore;**

Shërbimet shëndetësore vazhdimisht janë në evoluim, si në zhvillimin e procedurave të reja diagnostike ashtu edhe në qasjen me të integruar me pacientin në qendër të vëmendjes për sa i takon trajtimin spitalor. Objektet spitalore si në QKUK ashtu edhe në Spitalet e Përgjithshme, shumica e tyre të ndërtuara prej më shumë se disa dekadave, kërkojnë vazhdimisht ndërhyrje në funksion të mirëmbajtjes dhe përmirësimit të infrastrukturës së tyre. Përveç kësaj, nevoja për objekte të reja shëndetësore në kuadër të SHSKUK-së është mëse evidente.

Prioritet kryesorë në këtë fushë janë: ndërtimi i klinikës për sëmundjet e mushkërive në QKUK, ndërtimi i objektit për depon qendrore të barnave në QKUK dhe zgjerimin e depove në 7 Spitalet e Përgjithshme.

Është siguruar buxheti për fillimin e ndërtimit të aneksit për Klinikën e Nefrologjisë dhe Hematologjisë, pritet të përfundojë ndërtimi i aneksit të Ortopedisë, vazhdon ndërtimi të Spitalit

për Nena dhe Fëmijë në Prizren si dhe prioritet të përfundoj mbindërtimi i sallës së kateterizimit për kardiologji invazive në Prizren.

**Janë prioritetizuar këto aktivitete:**

1. Ndërtimi i Spitalit për nënë dhe fëmijë në Prizren-Vazhdim
2. Fillimi i ndërtimit të Klinikës së Nefrologjisë dhe Hematologjisë
3. Mbindërtimi i sallës së kateterizimit-kardiologjia invazive në SP të Prizrenit-Vazhdim
4. Ndërtimi i Aneksit të Klinikës së Ortopedisë në QKUK-Vazhdim
5. Hartimi i projektit ideor për depon qendrore të barnave dhe materialit shpenzues mjekësor për ShSKUK.
6. Renovimet në klinikat e QKUK sipas prioriteteve në bashkëpunim me MSh
7. Adaptimi i infrastrukturës për personat me nevoja të veçanta,
8. Rregullimi i nyjeve sanitare në hapësirat e QKUK dhe njësisve tjera të ShSKUK
9. Furnizimi me inventar medicinal dhe administrative në ShSKUK

#### **VIII. Objektivi. Digjitalizimi i sistemeve në kuadër disa shërbimeve në QKUK në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë;**

**Aktivitetet kryesore janë:**

1. SMSF: funksionalizimi në tërësi i sistemit në fjalë;
2. Zgjerimi i rrjetit të digjitalizimit dhe terminëve në të gjitha ambulancat specialiste në kuadër të QKUK-së;
3. Sistemi për regjistrim të resurseve humane dhe vijueshmëri;
4. Fillimi i aktivizimit të sistemit digjital të regjistrimit të pacientëve (Pilot projekt- Klinika e Onkologjisë);
5. Mundësia e aktivizimit të PACS në kuadër të ShSKUK-së;
6. Mundësia e digjitalizimit të sistemit të alarmit të pacientëve të hospitalizuar.

#### **Objektivi IX. Përgatitja e planit të detajuar për reagim në emergjencë;**

**Aktivitetet kryesore janë:**

1. Përgatitja e planit të detajuar për reagim në emergjenca;
2. Krijimi i grupit punues për përpilimin e planit të detajuar për reagim në emergjenca për të gjitha objektet spitalore;
3. Trajnimi i stafit për reagim në situata emergjente.

**Objektivi X. Kontrollimi mjekësorë sistematik i stafit të ShSKUK-së;**

**Aktivitetet kryesore janë:**

1. Kontrolli sistematik i personelit shëndetësor dhe mbështetës;
2. Krijimi i në grupi që do të përpilojë planin e detajuar për implementimin e këtij projekti;
3. Raporti final i gjendjes shëndetësore të punonjësve të ShSKUK-së.

**Objektivi XI. Reformat administrative**

**Aktivitetet kryesore janë:**

1. Plotësim ndryshimi i Statutit të SHSKUK;
2. Plotësim ndryshimi i Statutit të QKUK;
3. Plotësim ndryshimi i Stautit të QSKUK;
4. Plotësim ndryshimi i Stautit të Spitaleve Rajonale
5. Hartimi i Rregullores për sistematizim dhe përshkrim të vendeve të punës në njësitë përbërse të ShSKUK;

PLANI DETAJ PËR VITIN 2023

Nr	OBJEKTIVAT	AKTIVITETET	Indikator	AFATI KOHOR	Kostoja	Burimi i financimit	PËRQJEGJËSIT	Rezultati	MUNDËSITË dhe REZIQËT (SUPOZIMET)
I.	Furnizimi i qëndrueshëm dhe i rregullt me barna dhe material shpenzues mjekësorë	I.1. Furnizimi i qëndrueshëm me barna dhe material shpenzues medicinal	Planifikimi i drejtë dhe efikas për furnizim me barna dhe material shpenzues Menaxhimi efektiv i kontratave për furnizim me barna dhe material medicinal Inicimi i procedurave të prokurimit me kohë Trajnimi i menaxherëve të kontratave	TM1/2/3/4	Rreth 30 milion €	SHSKUK MSH MEF (rishikimi i buxheti) Donatorët	Drejtori i SHSKUK Menaxherët e kontratave Barnatorja Qndrore MSH MEF Qeveria e RKS	Kontratat e menaxhuara në mënyrë efektive Procedurat e prokurimit të inicuar në kohë	Buxheti i limituar Menaxherët kompetent për menaxhim të kontratave
II.2.	Shpërndarja e produkteve medicinale në kohë sipas kërkesave të njëjësive respektive		Kërkesat e bëra me kohë nga njësitë kërkuese Shpërndarja në kohë	TM1/2/3/4		ShSKUK MSH	Njësitë kërkuese (SP dhe Klinikat e OKUK) Barnatorja Qendore	Kërkesat janë procedurara në kohë Shpërndarja është realizuar në	Buxheti i limituar Kërkesat bëhen me kohë Shpërndarja bëhet me kohë



<p>II.4. Sigurimi i resurseve të nevojshme (burimet ne njerëz dhe buxheti) për zbatimin e planit të veprimit, si dhe zbatimi i planit për reduktimin e listave të pritjes;</p>	<p>Resurset e nevojshme për zbatimin e planit të veprimit Puna në dy nderrime</p>	<p>TM2/3/4</p>		<p>SHSKUK</p>	<p>Drejtori i SHSKUK Drejtorët e Klinikave Bordi drejtues</p>	<p>Resurse të nevojshme sipas PV</p>	<p>Buxheti / mungesa e resurseve - anesteziologeve</p>
<p>II.5.Funksionalizimi i Rezonancës Magnetike në Spitalin e Pejës dhe Spitalin Pediatric do të ndikojë dukshëm në reduktimin e listave të pritjes në Klinikën e Radiologjisë për Rezonancë Magnetike</p>	<p>Reduktimi i listave të pritjes</p>	<p>TM 2/3/4</p>		<p>SHSKUK</p>	<p>Drejtori i SHSKUK Drejtori i Radiologjisë dhe Sp. të Pejës</p>	<p>Reduktim i listave të pritjes për se paku 50%</p>	<p>Stafi profesional i limituar</p>
<p>II.6.Vazhdimi i operimit të venave varikoze me radiofrekvenca do të ndikojë në reduktimin e listave të pritjes për venat varikoze, sepse bëhet me anestezi lokal,</p>	<p>Reduktimi i listave të pritjes</p>	<p>TM 2/3/4</p>		<p>SHSKUK</p>	<p>Drejtori i SHSKUK Drejtori i Kirurgjisë Vaskulare</p>	<p>Reduktim i listave të pritjes</p>	<p>Numer i vogel i shtrereve per paciente ne klinike</p>



	pa patur nevojë për angazhimin e anesteziologut.							
III. Kontrolli dhe parandalimi i Infeksioneve brendasptalor e	III.1. Funkcionalizimi i Këshillit për infeksione spitalore	Emërimi i Këshillit për infeksione brendasptalore	TM1		ShSKUK	Drejtori i SHSKUK		
	III.2. Vendosja e zonave të filtrit në të gjitha blloqet operative të klinikave të QKUK-së dhe se paku në 50% të sallave kirurgjike në Spitalet e Përgjithshme	Implementimi i filtrave në blloqet operative	TM2/3	290,000 €	ShSKUK	Drejtori i SHSKUK Drejtorët e Klinikave DASHPT	Realizimi i punimev dhe funksionalizimi I tyre, reduktimi I infeksioneve spitalore	Procedurat tenderuese/buxheti limituar
	III.3. Zhvillimi i PSO për sallat kirurgjike dhe njësitë e kujdesit intensiv	Themelimi i grupit Punues Hartimi i draftdokumentit të SOP	TM2/3	1,000 €	ShSKUK	Këshilli për Kontrollë të Infeksioneve brendasptalor e Drejtori i SHSKUK Bordi Drejtues	SOP e zhvilluara	
	III.4. Sigurimi i uniformës dhe	Ngritja e nivelit të furnizimit me	TM1/2/3/4	100.000 €	SHSKUK	Drejtori i SHSKUK	Ngritja e nivelit të	Procedurat tenderues/ buxheti

mbathjes së mjaftueshme për personelin e sallave operative /kirurgjike, dezinfektimi i rregullt i sallave kirurgjike	uniforma, pastrim dhe dezinfektim ne blloqet operative				Bordi Drejtues Drytoret e Klinikave DASHPT	pastetis dhe higjienes	i limituar
III.5. Furnizimi me carshafa, mbulesa dhe mbështjellës të jashtëkut për shtretërit e pacientëve; si dhe sigurimi i uniformes dhe mbathjes se mjaftueshme për personelin shëndetësor dhe mbështetës;	Furnizimi me uniforma, carqaf dhe material te nevojshem per shtreter te pacienteve	TM1/2/3/4	200.000 €	SHSKUK	Drejtori i SHSKUK Bordi Drejtues Drytoret e Klinikave DASHPT	Ngritja e nivelit te pastetis dhe higjienes	Procedurat tenderues/ buxheti i limituar
III.6. Krijimi i njësisë për pastrim dhe dezinfektim të shtretërve në QKUK,	Formimi i njësis për pastrim dhe dezinfektim të shtretërve	TM2/3	100.000 €	SHSKUK	Drejtori i SHSKUK	Reduktimi i infeksioneve spitalore	Procedurat tenderuese, lloji I shtreterve ekzistues
III.7. Gjurmimi (Screening) për bakterie shumë rezistente në njësitë më të ndjeshme		TM2/3/4		SHSKUK	Drejtori i SHSKUK Sherbimi mikrobiologji k Njësitë e	Reduktimi i infeksioneve spitalore-bakterieve multirezisten te	

(vulnerable),						Kujdesit intensiv dhe sallat operate		
III.8. Zvogëlimi i prevalences së infeksioneve në HCV Qendrat e Dializës në SHSKUK			TM2/3/4	10,000 €	ShSKUK	Drejtori i SHSKUK Njësitë e hemodializës në SHSKUK Sherbimi mikrobiologjik		
IV.1 Themelimi i Sherbimit te Transportit Neonatal ne Kliniken Pediatricë në OKUK	Sherbimi i themeluar dhe funksional Trajnimi I stafit		TM2	150.000 €	MSh SHSKUK	Drejtori i SHSKUK Bordi Drejtues i SHSKUK MSH	Sherbimi i themeluar dhe funksional Staf I trajnuar	Transporti I neonateve nga periferia në qendër
IV.2 Themelimi i njësisë së Fertilizimit të Asistuar Mjekësorë në Kliniken Obstetrike Gjinekologjike;	Sigurimi pajisjeve mjekësore Trajnimi I stafit		TM4	1. milion €	MSh	Drejtori i SHSKUK Drejtori i KOGJ Bordi Drejtues i SHSKUK MSH	Pajisjet mjekësore të siguruarra Staf I trajnuar	Yonesat në prokurim
IV.3. Avancimi dhe zgjerimi i garrës së sherbimeve mikrobiologjike në Sherbimin	Fillimi i sherbimeve për pacientët		TM2	20,000 €	SHSKUK	Drejtori i SHSKUK Bordi Drejtues i SHSKUK MSH	Shërbimet e ofruara për pacientët	Buxheti i limit. Yonesat në prokurim

IV

Themelimi i sherbimeve të reja dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë së sherbimeve shëndetësore

Mikrobiologjik te OKUK								Stafi duhet të trajnohet jashtë vendit. Funkcionalizimi I plotë do të reduktojë referimir e pacientëve jashtë institucioneve publike shëndetësore.
IV.5. Themelimi i Njësise Fetale në Klinikën Obstetrike Ginekologjike;	Statuti I OKUK Trajnimi I Stafit	TM2/3/4		Msh ShSKUK	Drejtorët e Neonatologjisë dhe KOGJ Drejtori I ShSKUK Grupi punues per Statutin e OKUK MSH	Statuti I OKUK I miratuar Stafit I trajnuar		
IV.6. Themelimi i njësise për përçjelljen e pacientëve para dhe pas transplantimit të veshkës në kuadër të Klinikës së Nefrologjisë	Adaptimi I hapesirave Trajnimi I stafit	TM 3/4	10.000 €	ShSKUK Msh	Drejtori I Klinikës së Nefrologjisë, Drejtori I ShSKUK Bordi Drejtnes	Funksionalizimi I plotë	Nuk do të ketë nevojë që pacientët të referohen jashtë institucioneve publike shëndetësore.	

<p>IV.7. Funksionalizimi i endoskopisë pediatrike (bronhoskopia, gastroskopia dhe kolonoskopia);</p>	<p>Sigurimi I pajisjeve Trajnimi I staffit</p>	<p>TM3/4</p>	<p>150.000 €</p>	<p>ShSKUK MSh</p>	<p>Drejtori I Klinikës së Kirurgjisë së Femijëve dhe Pediatrisë, Drejtori I ShSKUK</p>	<p>Funksionalizimi I plotë</p>	<p>Nuk do të ketë nevojë që pacientët të referohen jashtë intencioneve publike shëndetësore.</p>
<p>IV.8.Funksionalizimi i kirurgjisë laparoskopike dhe nefrolitotomisë perkutane në Klinikën e Urologjisë;</p>	<p>Sigurimi I pajisjeve Trajnimi I staffit</p>	<p>TM1/2/3</p>		<p>ShSKUK</p>	<p>Drejtori I Klinikës së urologjisë, Drejtori I ShSKUK</p>	<p>Funksionalizimi I plotë</p>	<p>Funksionalizimi I plotë do të reduktojë referimin e pacientëve jashtë intencioneve publike shëndetësore</p>
<p>IV.9. Funksionalizimi i Laboratorëve diagnostike patologjike dhe citologjike në të gjitha Spitalet e Përgjithshme,</p>	<p>Blerja e pajisjeve mjekësore, Trajnimi i staffit shëndetësorë, Sigurimi i hapësirës adekuate,</p>	<p>TM2/3/4</p>	<p>100,000 €</p>	<p>ShSKUK, Spitalet Rajonale</p>	<p>Drejtori i ShSKUK Spitalet Bordi Drejtues i ShSKUK</p>	<p>Shërbimet e ofruara për pacientët</p>	<p>Buxheti i limitit. Vonesat në prokurim Mungesë e hapësirave adekuate ne Spitale</p>
<p>IV.10 Zbatimi i Planit të veprimit për furnizim të qytetarëve me proteza, ortoza dhe shërbime tjera të cilat ofrohen në SHKOP/SHSKU K,</p>	<p>Rishikimi i shërbimeve</p>	<p>TM2</p>	<p>-</p>	<p>SHSKUK</p>	<p>Drejtori i ShSKUK Klinikat Bordi Drejtues i MSH</p>	<p>Shërbimet e ofruara për pacientët</p>	<p>Vonesat ne analizen e situates dhe shërbimeve</p>
<p>SHKOP/SHSKU K,</p>	<p>Trajnimi i personelit shëndet.</p>	<p>TM3</p>	<p>-</p>	<p>SHSKUK</p>	<p>Drejtori i ShSKUK Klinikat Bordi</p>	<p>Shërbimet e ofruara për pacientët</p>	<p>Personeli shëndetësi i limitit.</p>

						Drejtnes MSH		
	Blejja e pajisjeve dhe materialit shpenzues mjek.	TM3			SHSKUK	Drejtori i SHSKUK Klinikat Bordi Drejtues	Shërbimet e ofnuara për pacientët	Buxheti i limit. Vonesat në prokurim
IV.11. Rritja e kapaciteteve dhe cilësisë së shërbimeve oftalmologjike, si ne pjesën diagnostike ashtu edhe në arë operative në Klinikën e Oftalmologjisë	Sigurimi I pajisjeve	TM3/4	500,000 €	MSh	Drejtori I Klinikës së Oftalmologjisë Drejtori I SHSKUK Bordi Drejtues MSH	A Vancimi shërbimeve ne diagnostikë dhe operative	Funksionalizimi I plotë do të reduktojë referimit e pacientëve jashtë intubacioneve publike shëndetësore	
IV.12. Sigurimi i vazhdimësisë së punës në Njësinë e Elektrofiziologjisë së Zemrës ne Kl. e Kardiologjisë,	Sigurimi I materialit shpenzues Trajnimi I stafit vendor	TM1/2/3/4		SHSKUK,	Drejtori I Kardiologjisë Drejtori i SHSKUK	Shërbimet e ofnuara për pacientët	Buxheti i limit. Vonesat në prokurim Nuk do të ketë nevojë që pacientët të referohen jashtë intubacioneve publike shëndetësore.	
IV.13. Trajtimi stomatologjik i pacientëve me sedacion inhalator (oksidul-azot)	Sigurimi I pajisjeve, trajnimin I stafit, UA dhe udhërrëfyesi per kete shërbim	TM2/3	10,000 €	QKSUK	SHSKUK, QKSUK MSh	Shërbimet e ofnuara për pacientët	Procedurat e prokurimit Trajtimi optimal I pacientëve	

	IV. 14. Aplikimi i terapisë fikse ortodontike	Sigurimi i materialit shpenzues	TM1	30,000 €	QKSUK	SHSKUK, QKSUK	Shërbimet e ofruara për pacientët	Procedurat e prokurimit Ofrimi i shërbimit shërbimeve te reja
	IV. 15. Furnizimi me unit kirurgjik dhe pjesamentë kirurgjikë me qëllim të përmirësimit të punës dhe përgaditja per aplikimin e terapisë me implante dentare	Fillimi i imlementimi te shërbimit	TM4	30,000 €	QKSUK	SHSKUK, QKSUK	Shërbimet e ofruara për pacientët	Procedurat e prokurimit Ofrimi i shërbimit te ri
	IV. 16 Fillimi i realizimi të projektit për sallën kirurgjike Endovaskulare në Kirurgji Vaskulare	Adaptimi i salles operative, Sigurimi i pajisjeve dhe trajnimi I stafit	TM3/4	1.200.000 €	MSh	Kirurgjia vaskulare, SHSKUK MSh	Hapësirat e adaptuara, stafi I trajnuar, pajisjet e siguruara	Funksionalizimi I plotë do të reduktojë referimet e pacientëve jashtë intubacioneve publike shëndetësore
	IV. 17 Fillimi i realizimi i projektit për sallën e Neurokirurgjisë.	Adaptimi i salles operative, Sigurimi I pajisjeve dhe trajnimi I stafit	TM3/4	2.300.000 €	MSh	Neurokirurgji a SHSKUK MSh	Hapësirat e adaptuara, stafi I trajnuar, pajisjet e siguruara	Funksionalizimi I plotë do të reduktojë referimet e pacientëve jashtë intubacioneve publike shëndetësore
	IV.18. Fillimi i shërbimeve specialistikë në Spitalin e Podujevës,	Rekrutimi i stafit Organizimi I punes Adaptimi I hapësirave	TM 3/4		SHSKUK	SHSKUK Spitali I Podujevës	Shërbimet e ofruara për pacientët	Funksionalizimi i cili do të reduktojë numrin e pacientëve qe marrin shërbime specialistikë ne OKUK

<p>V</p> <p>Menaxhimi efikas, rritja e transparencës dhe llogaridhënies</p>	V.1. Hartimi dhe miratimi i Rregullores për sistematizimin dhe përshkrimin e vendeve të punës	Themelimi i grupit punues	TM 2		SHSKUK, MSH	Drejtori i ShSKUK Bordi Drejtues i ShSKUK	Grupi punues i themeluar	Personeli i limit
	V.2.Hartimi dhe miratimi i rregulloreve për organizimin e punës në të gjitha klinikat e QKUK;	Hartimi i Rregulloreve	TM2		SHSKUK, MSH	Grupi punues Asistanca teknike nga partnerët donatorë	Rregulloret e miratuar	Personeli i limit
		Themelimi i grupeve punuese Hartimi i Rregulloreve	TM/1/2/3		SHSKUK	Drejtori i ShSKUK Bordi Drejtues i ShSKUK	Rregulloret e miratuar	Personeli i limit
	V.3 dhe 4. Hartimi i planit të burimeve ne njëtrëz-planifikimi i trajnimit dhe shfrytëzimi efikas i burimev njerzore ( tregus mates per vlersimin e stafit- )			TM2/3/4	SHSKUK,	Drejtori i ShSKUK Bordi Drejtues i ShSKUK Zyra/ e Burimev Njerzore	Plani i burimeve njerzore, Plani i trajnimit	Personeli i limit
V.5, 6 dhe 7. Fuqizimi i komunikimit të drejtpërdrejtë dhe sistematik i SHSKUK me qytetarët dhe	Nr. i aktiviteteve direkte të ndërlidhura me komunikim Nr.i postimeve në web-faqen zyrtare të	TM2/3/4		SHSKUK,	Drejtori i ShSKUK, Drejtorët e SP Drejtorët e Klinikave Zyra për media	Aktivitetete të realizuara të komunikimit Linjat telefonike të krijuara / Aktivitetete /	Personeli i limit Buxheji i limituar	



	shoqatata për mbrojtjen e të drejtave të pacientëve. Azhurimi i rregullt i web faqes se SHSKUK/QKUK	ShSKUK Krijimi i linjave telefonike falas Nr. i takimeve/aktivitet, me Shoqatat për MDP				Shoqatat per MDP	takime të realizuara me Shoqatat MDP		
	V.8 Ngrjita e cilësisë së raporteve periodike dhe vjetore nga të gjitha njësitë përbërëse të SHSKUK	Zhvillimi i modelit të raporteve me objektiva dhe indikatorë qartë dhe lehtë të matshëm	TM/3/4		SHSKUK,	Drejtori i ShSKUK Njësite Përbërëse të SHSKUK-së Divizioni për monitorim dhe kontrollë të cilësisë Asistencë teknike nga partnerët	Modeli i raportimit i zhvilluar	Personeli shëndet: i limit Buxheti i limituar	
VI.	Furnizimi me pajisje mjekësore, servisimi dhe mirëmbajtja e tyre e rregullt	VI.1,3,4,5.: Sigurimi i një acceleratori të ri për radioterapi për nevojat e Klinikës së Onkologjisë, Sigurimi i aparatit për plazmaferëzë - të përbashkët për nevojat e Klinikave të	Llojet dhe numri i pajisjeve mjekësore të siguruara	TM 3/4/5	2.200,000 €	SHSKUK	Bordi Drejt. ShSKUK Drejtori i SHSKUK, Drejtorët e SP Drejtorët e Klinikave Sektorit i pajisjeve mjekësore QKUK	Pajisjet e siguruara, Implementim i i shërbimeve mjekësore	Buxheti i limit. Yonesat në prokurim.

<p>QKUK; Sigurimi i pajisjeve mjekësore te nevojshëm për laobartoret e histopatologjise për Spitalet e Përgjithshme. Sigurimi i pajisjeve mjekësore bazuar në prioritetet e njësisve të ShSKUK,</p>								
<p>VI.2, 7. Pajisjet per FAM, oftalmologji si dhe disa pajisje të tjera bashkëpunim me MSh. Sigurimi e Autoambulancës për transportin neonatal,</p>	<p>Llojet dhe numri i paisjeve mjekësore të siguruar</p>	<p>TM 3/4/5</p>	<p>2.2 milion €</p>	<p>MSh</p>	<p>Bordi Drejt. ShSKUK Drejtori i ShSKUK, Drejtorët e SP Drejtorët e Klinikave Sektori i pajisjeve mjekësore QKUK</p>	<p>Pajisjet e siguruar, Implementim i sherbimeve mjekësore</p>	<p>Fillimi i sherbimeve të reja për pacientë</p>	
<p>VI.6. Servisimi i rregullt dhe mirëmbajtja e pajisjeve mjekësore – hartimi i planit operativ për</p>	<p>Llojet dhe numri i paisjeve mjekësore të siguruar</p>	<p>TM1/2/3/4</p>	<p>300,000 €</p>	<p>SHSKUK</p>	<p>Drejtori i ShSKUK, Drejtorët e SP Drejtorët e Klinikave Sektori i pajisjeve</p>	<p>Krijimi planit operativ vjetor te mirëmbajtje s së paisjeve</p>	<p>Staffi i limituar, mungesa e nje programi per menaxhimin e paisjeve</p>	

	servisim dhe mirëmbajtje.					injektore QKUK		
VII. Përmirësimi dhe zgjerimi i ambienteve spitalore- investimet kapitale	VII.1.. Ndërtimi i Spitalit për nëna dhe fëmijë në Prizren- Vazhdim	Vazhdimi i punimeve ndërtimore në SP të Prizrenit sipas planit dinamik	TM11/2/3/4	1, 600,000€	SHSKUK	Drejtori i SHSKUK, Menaxheri /kompania menaxh. e kontratës kompania ndërtuese SP Prizrenit	Punimet ndërtimore të kryera sipas planit	Kapacitetet e kompanisë ndërtuese
	VII.2. Fillimi i ndërtimit të Klinikës së Nefrologjisë dhe Hematologjisë	Punët e filluara ndërtimore	TM3/4	1,000,000 €	QKUK	Drejtori i SHSKUK SHPTA të QKUK Bordi Drejt. SHSKUK	Punët ndërtimore të kryera sipas planit	Procedurat tenderuese/ thehëgjia e kompanisë nga kontrata
	VII.3.. Mbindërtimi i sallës së kateterizimit- kardiologjia invazive në SP të Prizrenit- Vazhdim	Vazhdimi i punimeve ndërtimore sipas planit/ aneksa kontaktat përshatja për paisjet Angiografi	TM3/4	80,000 €	SHSKUK	Drejtori i SHSKUK Menaxheri i kontratës kompania ndërtimore Drejtori i SP Prizren	Punët ndërtimore janë kryer sipas planit	Kapacitetet e kompanisë së ndërtimit Punë shtesë /të paparashikuara
VII.4. Ndërtimi i Aneksit të Klinikës së Ortopedisë në QKUK- Vazhdim	Vazhdimi i punimeve sipas planit dinamik	TM2/3/4	1,000,000 €	QKUK	Menaxheri i kontratës kompania ndërtuese SHPTA Drejtori i SHSKUK	Punimet përfundojnë me kohë, sipas planit dinamik	Punë shtesë /të paparashikuara Kapacitetet e kompanisë ndërtuese	

VII.5. Hartimi i projektit ideor për depon gendrore të barnave dhe materialit shpenzues mjekësor për ShSKUK.	Hartimi I projektit ideor	TM2/3		ShSKUK	Drejtori I ShSKUK ShPTA	Hartimi I projektit I perfunduar		
VII.6. Renovimet ne klinikat e QKUK sipas prioriteteve ne bashkëpunim me MSh	Hartimi I projekteve Realizimi I tyre	TM2/3/4	2,000,000 €	MSh	ShSKUK MSH	Hapesirat e renovuara	Vonestat ne procedura dhe kryerjen e punimeve	
VII.7. Adaptimi i infrastrukturës për personat me nevoja te veganta,	Fillimi I punimeve per pershtatjen e infrastrukturës per gasje per personat me nevoja te veganta	TM2/3/4	100,000 €	SHSKUK,	Drejtori i ShSKUK QKUK Spitalet Bordi Drejtues i ShSKUK	Finalizimi infrastruktur es/qasjes ne te gjitha hapsirat spitalore per personat me aftesi te kufizuar	Buxheti i limitit. Vonesat në prokurim	
VII.8. Rregullimi i nryeve sanitare në hapësirat e QKUK dhe njesive tjera të SHSKUK	Numri i nryeve sanitare të renovuara sipas njesive përberëse të SHSKUK	TM2/3/4	200,000 €	SHSKUK	SHPTA të QKUK SP Kompania fituese Menaxheri i kontratës	Janë kryer investime në përmirësimin e infrastrukturës nryeve sanitare të njesive përberëse të	Buxheti i limituar Kapacitetet e kompanisë fituese	



	regjistrimit të pacientëve (Pilot projekt- Klinika e Onkologjisë);	pacientin				Onkologjis Bordi Drejtues i ShSKUK	per te gjith paciente e onkologjise	
	VIII.5. Mundësia e aktivizimit të PACS në kuadër të ShSKUK-së;	Funksionalizimi i sistemit të PACS / LIS	TM2/3/4		SHSKUK	Drejtori i ShSKUK QKUK Spitalet Bordi Drejtues i ShSKUK	Realizimi i sstemit PASC/LIS	Procedurat e prokurimit/ buxheti i limituar
	VIII.6. Mundësia e digitalizimit të sistemit të alarmit të pacientëve të hospitalizuar.	Funksionalizimi i alarmit per pacientin e hospitalizuara	TM2/3/4		SHSKUK	Drejtori i ShSKUK QKUK Spitalet Bordi Drejtues i ShSKUK	Realizimi i sistemit te alarmit	Procedurat e prokurimit/ buxheti i limituar
	IX.1. Përgatitja e planit të detajuar për reagim në emergjencë;	Hartimi i planit të evakimit në rast të emergjencave	TM2/3/4		SHSKUK	Drejtori i ShSKUK QKUK Bordi Drejtues i ShSKUK	Plani i hartuar	Mungesa e kapaciteve profesionale
IX	Përgatitja e planit të detajuar për reagim në emergjencë;	IX.2. Krijimi i grupit punues për përpilimin e planit të detajuar për reagim në emergjencë për të gjitha objektet spitalore;	Hartimi i planit për vlerësimin e rrezikshmërisë në vend të punës	TM2/3/4	SHSKUK	Drejtori i ShSKUK QKUK Bordi Drejtues i ShSKUK	Plani i vledrshimit te rrezikshmeris	Mungesa e kapaciteve profesionale
		IX.3. Trajnimi i stafit për reagim	Ngritja e kapaciteteve per	TM2/3/4	SHSKUK	Drejtori i ShSKUK	Trajnim i stafit	Procedurat e prokurimit/

		në situata emergjente.	reagim emergjent/trajtimi i stafit				QKUK Bordi Drejtues i ShSKUK		buxheti i limituar
		IX.4. Menaxhimi i Pandemive COVID-19:	Monitorimi i menaxhimit te pandemie Covid 19		TM2/3/4		Drejtori i ShSKUK QKUK Bordi Drejtues i ShSKUK	Perfundimi i pandemie - Covid 19	
		X.1. Kontrolli sistematik i personelit shëndetësor dhe mbështetës	Impelementimi i kontrollit sistematik		TM2/3		Drejtori i ShSKUK QKUK Spitalet Bordi Drejtues i ShSKUK	Perfundimi i kontrollit mjeksor per te gjith personelin e ShSKUK-s	Krijimi i ekipeve monitoruese
X	Kontrollimi mjekësorë sistematik i stafit të ShSKUK-së	X.2. Krijimi i në grupi që do të përpilojë planin e detajuar për implementimin e këtij projekti;	Krijimi I grupit per perpilimin e planit te detajuar per kontroll sistematik		TM2/3		Drejtori i ShSKUK QKUK Spitalet Bordi Drejtues i ShSKUK	Raporti final i gjendes shëndetësore të punonjësve të ShSKUK-së.	
XI.	Reforma Administrative	XI.1. Plotësim ndryshimi i Statutit të ShSKUK	Hartimi i draft dokumentit		TM2		MSH Bordi Drej.ShSKUK Drejtori i ShSKUK, Grupi Punues Zyra Ligjore, Konsulta ligjore nga jashtë	Statuti i ShSKUK i plotësuar dhe ndryshuar	Mbështetja nga MSH dhe Qeveria e RKS

	XI.2. Plotësim ndryshimi i Statutit të QKUK	Hartimi i draft dokumentit	TM2		QKUK	MSH Bordi Drej. ShSKUK Drejtori i SHSKUK, Grupi Punues Zyra Ligjore, Konsulta ligjore nga jashtë	Statuti i QKUK i plotësuar dhe ndryshuar	Mbështetja nga MSH
	XI.3. Plotësim ndryshimi i Statutit të QSKUK	Themelimi i Grupit Punues Hartimi i draft dokumentit	TM2		QSKUK	MSH Bordi Drej. ShSKUK Drejtori i SHSKUK, QSKUK Grupi Punues Zyra Ligjore, Konsulta ligjore nga jashtë	Statuti i QSKUK i plotësuar dhe ndryshuar	Mbështetja nga MSH
	XI.4. Plotësim ndryshimi i Statutit të Spitalëve Rajonale	Themelimi i Grupit Punues Hartimi i draft dokumentit	TM2		Spitalet Rajonale	MSH Bordi Drej. ShSKUK Drejtori i SHSKUK Grupi Punues Zyra Ligjore, Konsulta ligjore nga jashtë	Statutet e njësive përberëse të ShSKUK të plotësuar dhe ndryshuara	Mbështetja nga MSH



	XI.5. Hartimi i Rregullores për sistematizim dhe përshkrim të vendeve të punës në njësitë përbëse të ShSKUK	Themelimi i Grupit Punues Hartimi i draft dokumentit	TM2	1,000 €	ShSKUK	MSH Bordi Drej. ShSKUK Drejtori i SHSKUK Grupi Punues Zyra Ligjore, Konsulta ligjore nga jashtë	Rregulloja e hartuar	Mbështetja nga MSH
--	---	--	-----	---------	--------	---	----------------------	--------------------